



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



SHËRBIMI PËRMBARIMOR
GJYQËSOR PRIVAT

Nr. 557/7 Prot

Tiranë, më 16.08.2019

Nr. 554 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë,

Unë, Haxhi Ismaili, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor, pranë Shoqërisë së Përmbardimit Privat "3H" SHPK, në referim të *Urdherit të Ekzekutimit* Nr.993 date 16.05.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë *urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbardimore Nr.554 date 19.04.2019 kërkesën e *Kreditorit*- Dega e Doganes Tirane për vënie në ekzekutim të *titullit ekzekutiv*, Vendimi për rikuperim me force të borxhit doganor me Nr.28 date 30.01.2019 i Degës Doganore Tirane, për *Debitorin* Iberaj Alk Shpk me NIPT L81612047A dhe Administrator Z.Iber Iberaj,

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori: *Iberaj Alk Shpk me NIPT L81612047A dhe Administrator Z.Iber Iberaj*, ka marrë njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit: *Iberaj Alk Shpk me NIPT L81612047A dhe Administrator Z.Iber Iberaj* në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbardimor Gjyqësor Privat",

Adresa Blv. "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Qendra e Biznesit, Kulla 2, Kt. 2, Zyra.17 Tirane

Website: www.3-h.al

Cel. 0692099711

Email: shpgj_3h@yahoo.com

URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, të bëjë bllokimin e kuotave dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi aksioneve nga:

Debitori:- Iberaj Alk Shpk me NIPT L81612047A dhe Administrator Z.Iber Iberaj

2. Për informimin, bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive, ku aplikohet sanksioni i gjobes në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzim për pengim ekzekutimi në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Ky urdhër është i vlefshëm deri në një urdhër të dytë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "3 H" SHPK PERMBARUES GJYQESOR

Haxhi ISMAILI



Adresa Blv. "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Qendra e Biznesit, Kulla 2, Kt. 2, Zyra.17 Tirane

Website: www.3-h.al

Cel. 0692099711

Email: shpgj_3h@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË

URDHËR EKZEKUTIMI (DUBLIKAT)
NR. 993 DATË REGJ 16.05.2019

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e përbërë nga gjyqtari:

BEZART KAÇKINI

Në Tiranë, sot më date 24.05.2019, mori në shqyrtim kërkesën që I përket:

- KERKUES:** Dega e Doganes Tirane
- OBJEKTI :** Leshim i dublikates se urdherit te ekzekutimit nr.621 date 01.04.2019 i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, me qellim venien ne ekzekutim te titullit ekzcKutiv per vendimin nr.28, date 30/01/2019 te Deges Doganore Tirane per zbatimin e masave garantuese dhe/ose per rikuperimin me force te borxhit doganor/te akcizes
- BAZA LIGJORE:** Neni 248, 280 i ligjit nr. 102, date 31/07/2014 "Kodit Doganor i Republikes se Shqiperise, neni 103 i ligjit 61/2012 "Per Akcizat ne Republikën e Shqiperise", neni 511, 514, e ne vijim i Kodit te Procedures Civile

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe akteve që i bashkëngjiten asaj

KONSTATOVA:

Se me vendim nr. 28 date 30.01.2019 nga ana e Deges se Doganes Tirane, ne reference te percaktimeve te nenit 280 te Ligjit Nr.102 dt.31.07.2014 "Kodit Doganor i Republikes se Shqiperise, eshte vendosur kontabilizimi i detyrimit doganore te papaguara te subjektit "IBERAJ-ALK" shpk me NIPT L81612047A i cili se bashku me kamatvonesat perben vleren totale prej **1.293.072 leke**.

Subjekti nuk rezulton te ketë kryer ankim administrativ sipas ligjit për këtë vendim.

Sa me sipër dhe referuar. Ligji nr. 8449 date 27.01.1999 "Kodi Doganor ne Republikën e Shqipërisë", ligjit 61/2012 "Për Akcizat", ligjit nr 10279/2010 "Për kundërvajtjet administrative" ky vendim përbën titull ekzekutiv.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në bazë të neneve 511 e vijues të K.Pr.Civile, si dhe në ligjin nr. 10279/2010 "Për kundërvajtjet administrative",


VENDOSI

1. Pranim i kërkesës se kërkesit Dega e Doganes Tirane.
2. Lëshimin i dublikates se urdhrit te ekzekutimit për ekzekutimin e vendimit nr.621 date 01.04.2019 i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, me qellim venien ne ekzekutim te titullit ekzekutiv per vendimin nr.28, date 30/01/2019 te Deges Doganore Tirane ndaj subjektit "IBRAJ -ALK" shpk me NIPT L81612047A.
3. Kundër këtij vendimi nuk mund te ushtrohet ankim.

- U shpall sot në Tiranë date 24.05.2019

SEKRETARE

GENTJANA MEHMETAJ



GJYQTARI

BEZART KAÇKINI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS TIRANË

Nr. 1218/ Prot.

Tiranë më, 30 / 01 / 2019

NJOFTIM

VENDIM Nr.28

PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR

Drejtuar: "IBERAJ-ALK", shpk Nipt: L81612047A

Adresë: TIRANE Zona industriale ish Kombinati i Tekstileve Nr.182

Në zbatim të Ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",

JU NJOFTOJMË SE:

Dega e Doganës Tiranë, me vendim nr.1257, datë 11/10/2018 ka vendosur për subjektin :
"IBERAJ-ALK", shpk Nipt: L81612047A, të shpallet debitor për:

- shumën 323,268 lekë në formë detyrimi doganor
- shumën 969,804 lekë në formë penaliteti
- kamatë vonesat deri në ekzekutimin e detyrimeve të papaguara.

Keto vendime, Ju janë komunikuar në datë 21/12/2018.

Në kushtet kur nga ana juaj deri më sot, nuk janë likujduar vullnetarisht detyrimet për t'u paguar sipas vendimit (aktit administriv) të sipërcituar, nuk është shfrytëzuar e drejta e kërkesës ankimore në respektim të kërkesave të nenit 45 të Kodit Doganor, duke bërë në këtë mënyrë që vendimi i mësipërm të marrë formë të prerë. Në këto kushte, në zbatim të nenit 45 të ligjit 102/2014 "Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë", nenit 103 të ligjit 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimit nr.15, datë 03/12/2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve

të papaguara doganore dhe të akcizës”, Dega Doganore ka nxjerrë vendimin **Nr. 28, dt.**

29/01/2019 “Per rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës”

Përmes vendimit **Nr. 28, dt. 29/01/2019** “Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/borxhin e akcizes”, Dega Doganore ka vendosur, si më poshte:

1. Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentave me anë të të cilave bëhen pagesa, valutë të huaj të depozituara në bankë që i përkasin debitorit, shoqërisë së mësipërme, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
2. Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme dhe të patundshme që i përkasin debitorit, shoqërisë së mësipërme ose personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
3. Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri ne masën që të bëhet e mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme të përcaktuara në Vendimin nr.1257 datë 11/10/2018 si dhe të kamatë vonesave të lindura, penaliteteve për çdo ditë vonesë në bazë të nenit 107 të Kodit Doganor deri në ditën e likuidimit të borxhit doganor.

KRYETAR
Arben KRASNIQI

Një kopje e kësaj letre është dorëzuar në datë _____ pranë qendrës së shoqërisë importuese si dhe agjentit doganor.

<hr/> <i>Firma e marrësit (ose ne rastin e personit juridik e perfaqësuesit)</i>	<i>Marresi nuk gjendet Shkresa e njoftimit ju dorezua :</i> <hr/> <i>Firma e _____ (Shënoni lidhjen e ketij personi me marrësin</i>	<i>Marrësi/personat e tjerë të përcaktuar nga ligji refuzojnë të nënshkruajnë.</i> <hr/> <i>Nepunësi që bën njoftimin/dëshmitari Jonisa Metani</i> <hr/> <i>Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari</i>
---	---	--